



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
eëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.Doc. 202001905/5

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandim për marrjen e masave në rastin e dhunës ndaj një të mituri X.X., nga punonjësit e Policisë së Shtetit

MINISTRISË SË BRENDSHME

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

AGJENSISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E DREJTAVE TË FËMIJËVE

PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

TIRANË

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni, nga mediat *online*, lidhur me publikimin e veprimeve të dhunshme e të rënda, të ushtruar nga forcat e Policisë së Shtetit ndaj të miturit X.X., ngjarje e ndodhur në afërsi të Liqenit Artificial të qytetit të Tiranës.

Në pamjet e transmetuara, shquhet qartësisht dhuna e ushtruar e forcave të rendit publik ndaj një të mituri, vetëm 15-vjeç, e në nevojë për mbrojtje. Kjo, për shkak të lëvizjes përtej fashës orare, të përcaktuar në aktin normative nr.3, date 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për Shëndetësinë.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i FFPopullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes “*ex-officio*” për rastin në fjalë.

Në këtë kontekst, në mënyrë të menjëhershme, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi informacione shpjeguese nga institucionet përgjegjëse të administratës shtetërore, konkretisht: Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme¹.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga veprimet e dhunshme, qartësisht evidente dhe të dallueshme, të ushtruara nga punonjësit e Policisë së Shtetit, publikoi qëndrimin e tij institucional, për reagimin e menjëhershëm të organeve kompetente, për të ndërmarrë veprimet urgjente karshi këtyre punonjësve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin, se ende nuk ka një reagim publik institucional, të formëzuar e të shprehur nga organet kompetente, përveç njoftimeve për shtyp, se SHÇBA, ka filluar hetimin administrativ e, ka pezulluar nga detyra punonjësien e Policisë së Shtetit, që ka ushtruar dhunë drejtëpërdrejt ndaj të miturit. Sikundër, nuk ka asnjë përgjigje zyrtare prej tyre në komunikimin shkresor dhe me email të institucionit tonë (si një prej formave ligjore të komunikimit administrativ, përcaktuar nga ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”), në zbatim të detyrimit ligjor, që

¹ Dërgimi i një emaili zyrtar tek këto institucione në datën 16 maj 2020.

institucionet shtetërore kanë në përputhje me pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës dhe ligjit 8454, date 4.2.1999 “ Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar².

Tash, të gjithë jemi të vetëdijshëm, që lufta kundër ushtrimit të dhunës është përgjegjësi e shtetit. Zbatimi i saj në praktikë, ndër vite ka qënë puna dhe angazhimi maksimal i të gjithë aktorëve publikë dhe jo publikë, por jo vetëm, edhe organizatave ndërkombëtare, institucioneve të pavarura, institucioneve të Bashkimit Evropian, për përmirësimin e kuadrit ligjor në vazhdimësi, organizimin e trajnimeve të ndryshme, për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve, që janë në shërbim të drejtpërdrejtë me fëmijët, organizimit të fushatave ndërgjegjësuese, ngritjes së institucioneve të reja për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve.

Një ndër aktorët kyç, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, është edhe Policia e Shtetit³. Po kështu, referuar parashikimeve të ligjit organik të Policisë së Shtetit, ky institucion ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut⁴.

Për sa më sipër, si dhe në vlerësim të situatës së pandemisë, e shoqëruar kjo me kufizimin e lëvizjeve së qytetarëve për një periudhë kohe relativisht të gjatë, dhuna e ushtruar nga forcat e Policisë së Shtetit karshi një të mituri, është e pajustificueshme dhe aspak profesionale, për më tepër në kundërshtim flagrant me legjislacionin ndërkombëtar e kombëtar të respektimit, mbrojtjes e garantimit të të drejtave të fëmijëve⁵. Po kështu, në mbështetje të nenit 133, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar , punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe, në këtë rast punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit⁶.

Në këtë kontekst, kufizimet në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve duhet të jenë vetëm ato të domosdoshmet, për të siguruar njohjen dhe respektimin e të drejtave të të tjerëve, për përmbushjen e kërkesave të drejta të moralit, rendit

² Pika 4, e nenit 63 të kushtetutës parashah se: “...*organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar ti paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij...*”.

³ Pika 3, e nenit 52, të ligjit nr.18/2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, parashikon se: “...*grupi teknik ndër sektorial ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë...*”.

⁴ Neni 2, i ligjit nr.108/2014 “ Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

⁵ Në pikën 1, të nenit 85, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, përcaktohet në mënyrë eksplicite se: “...*Punonjësi i policisë detyrohet të respektojë Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe të mbrojë të drejtat e liritë e njeriut...*”

⁶ Pika 1 dhe 2, të nenit 133, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

publik dhe mirëqënies së përgjithshme në një shoqëri. Asnjë i ndaluar nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit/dënimit mizor, çnjerëzor poshtëruës, ose ndonjë formë dhune ose kërcënimi dhe, sidomos në rastet e të miturëve, kjo është thelbësore.

Fëmijët duhet të trajtohen në atë mënyrë, që promovon ndjenjen e tyre të dinjitetit njerëzor dhe vlerave; që lehtëson riintegrimin e tyre në shoqëri (të miturit në konflikt me ligjin), që pasqyron interesin më të lartë të fëmijës dhe, merr parasysh nevojat e moshës.

Ndërsa, qeveria ka ndërmarrë një sërë masash, për të garantuar shëndetin e qytetarëve nga COVID-19, autoritetet shtetërore duhet të vlerësojnë dhe të kujdesen, që këto masa mos të cedojnë e çojnë në shkeljen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, si dhe të fëmijëve në veçanti, për të bërë të mundur mbrojtjen e qytetarëve dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, e sidomos, kur ato përdoren si mjet ndëshkimi nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Policimi në komunitet, si një koncept bashkëkohor, nënkupton një marrëdhënie bashkëpunimi, ndërmjet policisë dhe komunitetit, për të identifikuar dhe zgjidhur problemet e sigurisë së përbashkët⁷. Të gjithë jemi të vetëdijshëm, se detyrat parësore të forcave dhe shërbimeve të një policie demokratike janë: zbatimi i ligjit dhe ruajtja e qetësisë dhe rendit publik, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të individit, parandalimi dhe zbulimi i krimit, pakësimi i frikës dhe dhënia e ndihmës dhe shërbimeve ndaj publikut. Përparimi drejt policimit demokratik arrihet kur ka një ndryshim “nga një qasje e orientuar drejt kontrollit, në një qasje të orientuar drejt shërbimit” dhe, ku interesi kryesor i zbatimit të ligjit mbetet i përqendruar në parandalimin proaktiv të krimit⁸.

Në vijim referuar edhe të Raportit CPT- Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Çnjerëzor ose Trajtimi ose Dënimi Degradues, drejtuar qeverisë shqipëtare dhe rekomandimeve të adresuara në të, për luftën kundër torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit nga policia, në këtë raport nënvizohet nevoja e përsëritur për “zero tolerance” ndaj keqtrajtimit të personave të ndaluar. Gjithashtu, theksohet nevoja e trajnimit në vazhdimësi të punonjësve të policisë, sidomos në drejtim të

⁷ Neni 123, i ligjit nr.108/2014, i ndryshuar, parashah detyrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, për të marrë masat e duhura, në rast se një i mitur ka nevojë për mbrojtje.

⁸ Neni 80, i ligjit nr.108/2017 “Për Policinë e Shtetit”, përcakton detyrimin e strukturave të policisë në nivel vendor, për hartimin e strategjive të policimit në komunitet, në kuadrin e parandalimit të veprave penale.

programeve të trajnimit, që kanë të bëjnë me termat e përdorimit të forcës, si dhe kur duhet të përdoret ajo⁹.

Nenet 6, pika 2, 5, pika 9 dhe 23, pika 1, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcaktojnë, se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbështetet në një nga parimet kryesore, që Konventa e OKB-së dhe ky ligj parashohin, atë të respektimit të dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës, duke garantuar kështu, zhvillim të qëndrueshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social. Realizimi në praktikë i këtij parimi nga ana e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, do të thotë ofrimi i mbrojtjes për fëmijët nga çdo lloj forme dhune, duke i ofruar mbrojtje¹⁰.

Me qëllim mbrojtjen e fëmijës, është i domosdoshëm ofrimi i shërbimeve, sipas nevojave si dhe realizimin e ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e të miturit në mjedisin e tij familjar¹¹.

Në këtë kontekst, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson reagimin e ASHDMF¹² (pas informacionit zyrtar kërkuar nga ana e institucionit tone), duke dënuar modelin e punonjëve të Polisisë së Shtetit, për ushtrimin e dhunës kundrejt minorenit, si dhe masave që ka ndërmarrë kjo agjenci, duke referuar ndjekjen e rastit në strukturat përgjegjëse të Sektorit të të Miturve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në Bashkinë Tiranë.

Në informacionin zyrtar, dërguar nga ASHDMF rezulton, se Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Tiranë, ka reaguar menjëherë, pas raportimit të rastit nga ASHDMF, duke vendosur edhe kontaktet me Policinë Vendore të Tiranës e Policinë e Shtetit, për bashkëpunim në lidhje me identifikimin dhe ndarjen e të dhënave mbi rastin. Por, ajo që vërehet është fakti, se nuk ka marrë informacion e duhur e të plotë, me argumentin, se rasti po ndiqet nga SHBÇA në Ministrinë e Brendshme. Në këtë kuptim, Sektori për Mbrojtjen e Fëmijës, Bashkia Tiranë identifikoi rastin në fjalë nëpërmjet koordinimit të punës me Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës, në çdo njësi administrative.

⁹ Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 20 to 30 November 2018 This report has been published under an automatic publication procedure recently introduced by the Albanian authorities. Strasbourg, 17 September 2019

¹⁰ “Mbrojtje e fëmijës”, është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

¹¹ Nenet 53, i ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹² Emaili i ardhur ne datën 16.5.2020 nga ASHDMF, në përgjigje të emailit të institucioneve të AP-së.

Ndërkohë, nga informacioni i gjeneruar rezulton, se i mituri me inicialet X.X., i datëlindjes 10.3.2005, i dhunuar nga forcat e Policisë së Shtetit, është i regjistruara në gjendjen civile në Njësinë Administrative nr 2 dhe vendqëndrim aktual i tij së bashku me familjen, është në Njësinë Administrative nr. 6, Tiranë. Në zbatim të ligjit

17/2018 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, rasti po menaxhohet nga PMF, Njësia Administrative nr 6, Bashkia Tiranë.

Struktura e familjes së minorenit me inicialet X.X, përbëhet nga nëna, babai dhe dy fëmijë të tjerë, një motër dhe një vëlla. Prindërit e tij janë të divorcuar dhe ai jeton me nënën, motrën dhe vëllanë. Nga vlerësimi psiko-social, i realizuar nga PMF (që për hir të së vërtetës lë shumë për të dëshiruar), rezulton, se fëmija paraqeste një gjendje emocionale të qetë, nuk paraqitej i tronditur, pra në të përgjithshmen, gjendja e tij emocionale dhe fizike ka rezultuar pa probleme të natyrës psikologjike. Fëmija ndjek klasën e nëntë në shkollën 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, nëpërmjet frekuentimit të mësimit në platformën *online*. Gjithashtu, të miturit i janë prezantuar edhe të gjitha llojet e shërbimeve psiko-sociale për këshillim, edhe në situatë pandemie.

Po kështu, institucioni i AP, nisur nga rasti i paprecedent, por edhe në përmbushje të funksionit kushtetues të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti, kontaktoi me nënën e të miturit me inicialet X.X., për të garantuar mbrojtjen e tij. Dhuna ndaj fëmijëve është rreptësisht e ndaluar në çdo lloj rrethane, për më tepër kur ajo ushtrohet veçanërisht nga punonjës të administratës publike, punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët kanë si mision në ushtrimin e detyrës së tyre, mbrojtjen e jetës dhe lirive të qytetarëve, për më tepër kur ky qytetar është një i mitur dhe, vëmendja në këtë rast duhet të jetë e shtuar.

Nga informacioni i gjeneruar nga bashkëbisedimi me nënën dhe djalin e mitur në vazhdimësi, si dhe kryqëzimi i informacionit të marrë nga ASHDMF, rezulton, se shërbimi ndaj të miturit nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës, është ofruar në shkelje të nenin 51, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe të udhëzimit nr.253, datë 10.4.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës të fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkatuar nga COVID-19”. Ky legjislacion, e në mënyrë të veçantë udhëzimi i sipërpërmendur, përcaktojnë qartësisht, se punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, duhet të identifikojnë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe

në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familjen e fëmijës në rrezik, komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët, të bëjnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje, të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion, për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje, me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel qendror dhe vendor, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës.

Pavarësisht, se rasti është bërë publik, në shumë media visive dhe të shkruara, PMF e Njesisë Administrative Nr.6, së bashku me psikologun u gjendën në familjen e të miturit të dhunuar, pasditen e së nesërme së ngjarjes, menjëherë pas referimit të rastit nga ASHDMF dhe, sidomos, pas reagimit institucional të instiucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, referuar edhe informacionit të ardhur nga ASHDMF, rezulton se problematika e konstatuar nga Avokati i Popullit, lidhur me mungesën e bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të punës, ndërmjet strukturave në nivel vendor, sipas përcaktimeve të nenit 2, të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, vazhdon të jetë evidente dhe e pranishme¹³.

Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, shoqëruar kjo me kufizimin e lëvizjeve, institucioni i Avokatit të Popullit ka sjellë në vëmendje të autoriteteve përgjegjëse shtetërore, nëpërmjet publikimeve dhe deklarimeve të kryera në platformat *online* të institucionit, se masat e ndërmarra për karantinim, mund të rrisin rrezikun e ushtrimit të dhunës. Dhe, në këtë rast, dhunë ndaj fëmijës është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual¹⁴.

Në këtë kontekst, AP vëren se autoriteteve përgjegjëse shtetërore që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, jo vetëm që nuk kanë vlerësuar dhe marrë parasysh sugjerimet e institucionit tonë, por këto sugjerime nuk janë vlerësuar, as nga organet kompetente përgjegjëse të vendosjes së fashës/ave orar, për t’i bërë të mundur këto kufizime propocionalisht

¹³ Neni 2, i ligjit 18/2017 parasheh detyrimin për bashkëpunim, ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

¹⁴ Pika 3, e nenit 2, të ligjit 18/2017, “Pë të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

me të drejtat e fëmijëve, me qëllim eliminimin dhe parandalimin e dhunës të evidentuar në shumë raste gjatë situatës së pandemisë.

Në respektim të të drejtave të fëmijës, në interesin më të lartë të tyre, lidhur me publikimin e pamjeve filmike mefigurë e zë të fëmijës dhe të të dhënave të gjeneraliteteve në mediat *online* dhe vizive, institucioni i Avokatit të Popullit reason sërish, për të adresuar dhe zgjidhur këtë problematikë nga organet përgjegjëse.

Në përfundim, në mbështetje të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektoral në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, mbrojtja nga çdo formë e dhunës neglizhencës e abuzimit seksual dhe forcimi i shëndetit fizik e emocional të fëmijëve, është një komponent i të drejtave të tyre, në interesin më të lartë, si dhe duhet të ketë përparësi të jashtëzakonshme.

Është detyrë e të gjithëve së bashku, edhe në këtë situatë, që në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe, në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, të përpiqemi t'u garantojmë një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës në përcaktimin e qartë të detyrave të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave për largimin përgjithmon nga rradhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të punonjësve, që ushtruan dhunën e pajustificuar ndaj minorenit me iniciale X.X.
- Marrjen e masave nga organi i prokurorisë, për fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” sipas nenit 250, të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i RSH-së”, të ndryshuar, për dëmin fizik dhe moral, shkaktuar ndaj një të mituri me

iniciale X.X., në kuptim të pikës 5, të nenit 3, të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

- Marrjen e masave, për një bashkërendim më të konsoliduar, eficient dhe të realizuar në kohë e konkret, ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor, për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës X.X.
- Marrjen e masave, për organizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme për punonjësit dhe profesionistët e tjerë, që punojnë në fushat e rendit dhe sigurisë publike, për edukimin mbi/rreth të drejtave të fëmijës.
- Marrjen e masave, për hartimin e procedurave standarde operative për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të adresuara për këtë qëllim, si dhe aktet ndërkombëtare e kombëtare në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.
- Marrjen e masave, për kryerjen e testeve të gjendjes psiko-sociale dhe emocionale në mënyrë të herëpashershme, të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe profesionistëve, që punojnë apo janë në kontakt të drejtpërdrejt me fëmijët.
- Marrjen e masave, nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për monitorimin në vijëmbësi të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.
- Marrjen e masave, për ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive, për përcaktimin e rregullave më të detajuara, për sa i përket trajtimit të çështjeve të abuzimit/dhunës tek të miturit.

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA